

LIGJI Nr. 03/L-200

PËR GREVA

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,
miraton:

LIGJ PËR GREVA

Neni 1 Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim garantimin e lirive dhe të drejtave, lidhur me organizimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarve në Kosovë në grevë sipas standardeve ndërkombëtare.

Neni 2 Fushëveprimi

Me këtë ligj rregullohen dhe përcaktohen të drejtat e të punësuarve në grevë, kushtet dhe mënyra e organizimit të grevës, si dhe të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve dhe punëdhënësve gjatë mbajtjes së grevës.

Neni 3 Organizimi i grevës në organet shtetërore

Të punësuarit në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Policinë e Kosovës, Shërbimet e Zjarrfikësve, Shërbimet Emergjente Shëndetësore dhe në organet e tjera me interes të veçantë për Republikën e Kosovës, nuk kanë të drejtë në organizimin e grevës, nëse me ligj të veçantë nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 4 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

- 1.1. **Greva** - ndërprerje e organizuar e punës nga ana e të punësuarve me qëllim të realizimit të të drejtave dhe interesave ekonomike, sociale dhe profesionale nga marrëdhënia e punës;
- 1.2. **Grevistët** - të punësuarit të cilët pakënaqësinë e tyre lidhur me të drejtat, kushtet e punës, interesat ekonomike, sociale dhe profesionale i shprehin me anë të grevës;
- 1.3. **Këshilli Grevist** - organ i përkohshëm i zgjedhur nga të punësuarit që përfaqëson interesat e të punësuarve dhe udhëheq e koordinon grevën në emrin e tyre.
- 1.4. **Shërbime të rëndësishme jetike** - shërbimet të cilat për shkak të ndërprerjes së punës mund të shkaktojnë rrezikshmërinë e jetës dhe shëndetit të njerëzve ose mund të shkaktojnë dëme të përmasave të mëdha.

Neni 5 Pjesëmarrja në Grevë

1. Organizatat sindikale, apo gjysma e të punësuarve të një organizate të caktuar punuese, ku nuk ka organizim sindikal, kanë të drejt të organizojnë greva, për ti mbrojtur interesat e tyre ekonomike, sociale dhe profesionale.
2. Pjesëmarrja në grevë është vullnetare;
3. I punësuari nuk mund të detyrohet të marrë pjesë në grevë kundër vullnetit të tij.

Neni 6 **Kushtet e përgjithshme për organizimin e grevës**

1. Greva është e ligjshme kur plotësohen kushtet e më poshtme:
 - 1.1. organizohet nga një sindikatë, që ka cilësinë e personit juridik dhe është e regjistruar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 1.2. organizohet nga gjysma e të punësuarve brenda një organizate punuese;
 - 1.3. ka për qëllim të realizojë kërkesat nga marrëdhënia e punës, sipas ligjit dhe Kontratës së punës;
 - 1.4. kur sindikata, nga njëra anë, dhe organizata e punëdhënësve, nga ana tjetër, janë përpjekur më parë të bien dakord lidhur me kërkesat e tyre;
 - 1.5. nuk është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 7 **Arsyet e mbajtjes së Grevës**

1. Arsyet për ngritjen e të punësuarve në greva mund të jenë:
 - 1.1. moszbatimi i dispozitave ligjore të cilat mbrojnë interesin e punëtorëve;
 - 1.2. mos përmbushja e kërkesave ligjore të tyre, të cilat mbështeten në mbrojtjen e interesave sociale të punëtorëve;
 - 1.3. për shkak të mos pagesave të pagave;
 - 1.4. pasigurisë në punë;
 - 1.5. moszbatimi i dispozitave të Kontratës së Përgjithshme Kolektive dhe Kontratës së Punës, e lidhur në mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, si dhe
 - 1.6. për arsye të tjera të cilat kanë mbështetje në ligjet e zbatueshme të vendit tonë apo në konventa ndërkombëtare të punës.

Neni 8 **Paralajmërimi i grevës**

1. Këshilli i grevistëve ka për obligim të paralajmërojë grevën tek punëdhënësi dhe sindikata;
2. Këshilli i grevistëve ka për obligim që të paralajmërojë grevën jo më vonë se shtatë (7) ditë nga dita e caktuar për fillimin e grevës, duke ua dorëzuar vendimin për ngritjen në grevë organit të qeverisjes dhe organit punëdrejtues të organizatës, përkatësisht punëdhënësit.
3. Vendimin përmes të cilit paralajmërohet greva, duhet të përmbajë:
 - 3.1. arsyet për mbajtjen e grevës;
 - 3.2. kërkesat e punëtorëve;

- 3.3. vendin ku do të mbahet greva;
 - 3.4. kohën e fillimit dhe ditën e mbajtjes së grevës, si dhe
 - 3.5. kërkesën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë paqësore;
4. Greva paralajmëruese mund të zgjasë deri në një (1) orë në ditë.
 5. Këshilli Grevist ka për detyrë dhe përgjegjësi që gjatë kohës së mbajtjes së grevës, të mbajë rendin dhe qetësinë.
 6. Në rastet kur greva del jashtë kontrollit, Këshilli Grevist detyrohet t'i lajmërojë organet kompetente për mbajtjen e rendit.

Neni 9 Organizimi i grevës

1. Greva dhe greva e paralajmëruar mund të organizohen, në:
 - 1.1. ndërmarrje - greva te punëdhënësi;
 - 1.2. degë apo veprimtari - greva sipas veprimtarisë;
 - 1.3. nivel vendi - greva e përgjithshme.
2. Greva nuk mund të fillojë para procedurës së bisedimeve në mes punëtorëve dhe punëdhënësit, në mënyrë që të gjendet ndonjë zgjidhje për plotësimin e kërkesave të punëtorëve pa organizimin e grevës.
3. Vendimin për ngritjen e punëtorëve në grevë, në një organizatë, në një pjesë të organizatës ose të punëdhënësi, e merr organi i organizatës sindikale apo më shumë se gjysma e të punësuarve.
4. Vendimin për ngritjen e punëtorëve në grevë, në nivel federate apo veprimtarie, e merr organi i sindikatës, përfaqësuese të kësaj federate apo veprimtarie.
5. Vendimin për ngritjen e punëtorëve në grevë të përgjithshme e merr organi kompetent, sipas statutit të sindikatës.
6. Greva organizohet në pajtim me këtë ligj dhe aktet e tjera që janë në përputhje me këtë ligj.

Neni 10 Mënyrat e Organizimit të Grevës

1. Greva mund të organizohet, përmes:
 - 1.1. ndërprerjes së punës në vendin e punës;
 - 1.2. tubimit të të punësuarve në hapësirat e punës;
 - 1.3. mungesës së të punësuarave nga puna;
 - 1.4. tubimit të të punësuarve jashtë ambienteve të punës, dhe në hapësira tjera.

Neni 11 E drejta për grevë

1. Pjesëmarrja në greva lejohet nëse parashihet me ligj, me kontratën kolektive dhe me statutin e sindikatës.
2. I punësuar nuk mund të jetë i diskriminuar për shkak të organizimit dhe pjesëmarrjes në grevë;

3. Punëtorit nuk mundë t'i ndalohet e drejta për grevë, as të përdoret masa e ndëshkimit për të përfunduar grevën në kuptim të paragrafit 1. të këtij neni.

4. Ndaj të punësuarit mund të inicohet procedurë disiplinore, për organizimin dhe pjesëmarrjen në grevën që është në kundërshtim me ligjin.

Neni 12 Këshilli Grevist

1. Këshilli Grevist udhëheq me grevën dhe përfaqëson interesat e grevistëve.

2. Këshilli Grevist dhe përfaqësuesit e organeve të punëdhënësit që janë paralajmëruar për grevën, prej datës së paralajmërimit të grevës dhe gjatë grevës, kanë për detyrë që të insistojnë t'i zgjidhin kërkesat e tyre me marrëveshje.

3. Këshilli Grevist dhe të punësuarit të cilët marrin pjesë në grevë kanë për detyrë të organizojnë dhe të udhëheqin grevën në mënyrë që të mos rrezikohet siguria, shëndeti i njerëzve, pasuria, dhe të vazhdojnë punën pas përfundimit të grevës.

Neni 13 Mbrojtja e të drejtave të punësuarve gjatë grevës

1. Për organizuesit e grevës, pjesëmarrësve grevistë dhe ndaj të punësuarve të tjerë, të cilët mbështesin grevën, nuk mund të merren masa disiplinore apo materiale dhe nuk mund t'ju ndërpritet marrëdhënia e punës.

2. Gjatë grevës së organizuar sipas kushteve të përcaktuara me këtë Ligj, punëdhënësit nuk mund të punësojnë punëtorë të rinj të cilët do të zëvendësonin pjesëmarrësit në grevë.

Neni 14 Dëmtimi i pronës gjatë grevës

1. Nëse i punësuarit në kohën e grevës dëmton me qëllim pronën e punëdhënësit apo të personit të tretë, atëherë ndaj tij do të:

1.1. inicohet procedurë disiplinore;

1.2. kërkohet kompensimi i dëmit sipas procedurave gjyqësore.

Neni 15 Pamundësia e mbajtjes së grevës

1. Greva nuk mund të mbahet ose duhet të pezullohet në gjendje të jashtëzakonshme për aq kohë sa vazhdon kjo gjendje.

2. Gjendje të jashtëzakonshme janë: fatkeqësitë natyrore, gjendja e luftës, epidemitë dhe rastet kur vihet në rrezik liria e zgjedhjeve.

Neni 16 Sigurimi i minimumit të procesit të punës

1. Këshilli Grevist ka për detyrë që gjatë kohës së grevës të bashkëpunojë me organin punëdrejtues të organizatës, përkatësisht me punëdhënësin për të siguruar minimumin e procesit të punës dhe të prodhimit, kur një punë e tillë është e domosdoshme për jetën dhe sigurinë e qytetarëve ose është kusht i pazëvendësueshëm i jetës dhe punës së qytetarëve.

2. Minimumi i procesit të punës përcaktohet varësisht nga kushtet e veprimtarisë, shkallës së rrezikshmërisë së jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe rrethanave tjera të rëndësishme për realizimin e nevojave të qytetarëve, punëdhënësve dhe subjekteve tjera.

3. Gjatë përcaktimit të minimumit të procesit të punës sipas këtij neni, punëdhënësi është i obliguar të marrë mendimin e organit kompetent të sindikatës.

4. Me akt të brendshëm nënligjor të punëdhënësit, i cili duhet të jetë në përputhje me Ligjin dhe Kontratën Kolektive, përcaktohen punët dhe detyrat të cilat duhen të kryhen edhe gjatë mbajtjes së grevës.

Neni 17 **Shërbimet e rëndësisë jetike**

1. Organizimi i grevës në veprimtaritë me interes të veçantë publik, dhe në veprimtaritë në të cilat ndërprerja e punës, bazuar në natyrën e punës, mund të rrezikojë jetën, apo shëndetin e njerëzve, apo të shkaktojë dëme me pasoja të mëdha, mund të realizohet nëse plotësohen kushtet e veçanta të përcaktuara me këtë ligj. Si kusht i veçantë është që të sigurohet minimumi i procesit të punës dhe prodhimit, që të sigurohet jeta dhe shëndeti i njerëzve, apo mos shkaktimi i dëmeve me pasoja të mëdha.

2. Shërbime të rëndësisë jetike janë:

2.1. shërbimet e mbrojtjes për sigurinë e vendit;

2.2. shërbimet emergjente mjekësore dhe spitalore;

2.3. shërbimet e furnizimit me ujë;

2.4. shërbimet e furnizimit me energji elektrike;

2.5. shërbimet e kontrollit të trafikut ajror;

2.6. shërbimet e mbrojtjes kundër zjarrit;

2.7. shërbimet në burgje;

2.8. shërbimet për mbrojtjen e veterinarisë, kur janë në pyetje epidemitë e ndryshme;

2.9. shërbimet sanitare higjienike.

Neni 18 **Efektet e grevës së ligjshme**

1. Gjatë zhvillimit të grevës pezullohen detyrimet, që rrjedhin nga Kontrata e Punës.

2. Ndërprerja ose largimi nga marrëdhënia e punës për shkak të pjesëmarrjes në një grevë të ligjshme, është i kundërligjshëm.

3. Dispozitat nga paragrafi 2 i këtij neni, nuk zbatohet kur i punësuari, gjatë grevës, kryen një akt që bie në kundërshtim me ligjin.

Neni 19 **Efektet e grevës së paligjshme**

1. Kur greva nuk është e ligjshme, punëdhënësi mund t'i ndërpresë marrëdhënien e punës grevistëve.

2. Punëdhënësi ka të drejtë që ndaj punëmarrësve që nuk rifillojnë punën brenda tri (3) ditëve, të zgjidhë kontratën e punës me efekt të menjëhershëm.

3. Kur greva shoqërohet me veprime të paligjshme, palët i drejtohen gjykatës kompetente, e cila e përcakton përgjegjësitë e palëve, i cakton veprimet që ato duhet t'i kryejnë, e cakton dëmin e shkakuar dhe detyrimet e palës për zhdëmtimin e atij dëmi.

4. Në rast kontesti lidhur me ligjshmërinë e grevës, palët mund t'i drejtohen Gjykatës Kompetente.

Neni 20 Ndërprerja e grevës

1. Greva ndërpritet, kur:

- 1.1. janë përmbushur kërkesat e grevistëve;
- 1.2. arrihet marrëveshja me punëdhënësin;
- 1.3. këshilli Grevist vlerëson arsyeshmërinë e ndërprerjes së grevës dhe
- 1.4. kur janë në pyetje rastet e gjendjes së jashtëzakonshme të përcaktuara sipas nenit 15 të këtij ligji.

Neni 21 Ndalimi gjyqësor për greva dhe kompensimi i dëmit

1. Punëdhënësit dhe sindikatat mund të kërkojnë nga gjykata kompetente, që të ndalojë organizimin e grevës e cila është në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 22 Procedura e pajtimit

1. Procedura për pajtim fillon me propozimin e palëve, më së voni, në afatin prej shtatë (7) ditësh, prej fillimit të kontestit.
2. Partnerët social e caktojnë përbërjen dhe strukturën e Komisionit të Pajtimit.
3. Palët mund të pranojnë ose të refuzojnë propozimin e Komisionit të Pajtimit.
4. Marrëveshja e arritur në procedurën e pajtimit duhet të jetë në formë të shkruar.

Neni 23 Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, të Kontratës Kolektive dhe të akteve nënligjore me të cilat mund të shkelen të drejtat dhe detyrat e punëtorëve, përkatësisht të punëdhënësve, lidhur me grevën dhe pjesëmarrjen në grevë, e bën Inspektorati i Punës.

2. Në kryerjen e inspektimit, Inspektori i Punës është i autorizuar:

- 2.1. të bëjë mbikëqyrjen e akteve ligjore dhe nënligjore;
- 2.2. të bëjë evidentimin e dokumentacioneve të tjera për vërtetimin e fakteve dhe rrethanave të cilat janë me interes për mbikëqyrje;
- 2.3. të dëgjojë dhe marrë deklarata nga punëdhënësi, personat përgjegjës, Këshilli Grevist, përfaqësuesit sindikal, të punësuarit dhe personat e tjerë;
- 2.4. të angazhohet për ndërmarrjen e masave preventive dhe masave të tjera lidhur me shkeljet ligjore, me të cilat është i autorizuar në pajtim me ligjin.

3. Punëdhënësi, personi përgjegjës, Këshilli Grevist, përfaqësuesi sindikal dhe i punësuarit, janë të detyruar që inspektorit të punës t'i mundësojnë mbikëqyrjen, shikimin e dokumenteve, dhe mos pengimin në punën e tij, si dhe t'i ofrojnë dokumentacionin dhe informatat e nevojshme për kryerjen e inspektimit.

4. Për kryerjen e inspektimit dhe ndërmarrjen e masave, inspektori i punës, harton procesverbalin i cili përmban konstatimin zyrtar dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme. Procesverbali i dorëzohet punëdhënësit, këshillit grevist, përkatësisht sindikatave.

Neni 24 **Evidencat për grevat dhe refuzimin e punës nga të punësuarit**

1. Nga organi përgjegjës i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, duhet të mbahet evidenca, lidhur me:

- 1.1. numrin e grevave të organizuara;
- 1.2. kërkesat e parashtruara të grevistëve në grevë;
- 1.3. zgjatjen e grevës;
- 1.4. vendin dhe mënyrën e ndërprerjes së grevës;

2. Këshilli Grevist, është i detyruar që Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, t'i dorëzojë vendimin për organizimin dhe mbajtjen e grevës.

3. Këshilli Grevist dhe punëdhënësi, janë të detyruar që në afatin prej dy (2) ditësh, nga data e ndërprerjes së grevës, t'a informojnë MPMS-në për kohëzgjatjen dhe arsyet e ndërprerjes së grevës.

4. Punëdhënësi është i detyruar, që t'i dorëzojë MPMS-së, vendimin për përjashtimin e të punësuarve nga puna.

Neni 25 **Gjobat**

1. Me gjobë prej pesëqind (500) deri në pesëmijë (5000) Euro do të dënohet për kundërvajtje, punëdhënësi apo personi juridik ose personi përgjegjës i personit juridik, në qoftë se:

- 1.1. pengon të punësuarit për të marrë pjesë në grevë, sipas nenit 9 paragraf 1., të këtij ligji;
- 1.2. përdor masën e dhunës për të përfunduar grevën, sipas nenit 9 paragrafi 3., të këtij ligji;
- 1.3. pranon punëtorë të rinj, të cilët do t'i zëvendësonin pjesëmarrësit e grevës, sipas nenit 11 të këtij ligji; ose
- 1.4. vepron në kundërshtim me neni 16, paragraf 1. dhe paragrafi 2., të këtij ligji.

2. Me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë (1000) Euro, do të dënohet për kundërvajtje, sindikata ose këshilli grevist nëse :

- 2.1. gjatë grevës refuzojnë të bashkëpunojnë me organin punëdrejtues në organizatë, për të siguruar ushtrimin e minimumit të procesit të punës që siguron sigurinë e njerëzve dhe pasurisë, ose janë kusht i pazëvendësueshëm i jetës dhe punës së qytetarëve.
- 2.2. vepron në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji.
- 2.3. vepron në kundërshtim me nenin 15 të këtij ligji.

3. Me gjobë prej pesëdhjetë (50) deri në treqind (300) Euro do të dënohet për kundërvajtje, punëtori i cili gjatë grevës:

- 3.1. refuzon të bashkëpunojë me organin punëdrejtues në organizatë, për të siguruar ushtrimin e minimumit të procesit të punës, që siguron sigurinë e njerëzve dhe pasurisë, ose janë kusht i pazëvendësueshëm i jetës dhe punës së qytetarëve.

3.2. vepron në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji.

3.3. vepron në kundërshtim me nenin 15 të këtij ligji.

4. Të gjitha mjetet e grumbulluara nga gjobat e shqiptuara do të derdhen në Buxhetin e Kosovës.

Neni 26
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në afat prej gjashtë (6) muajsh, prej hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij ligji.

Neni 27
Shfuqizimi i akteve

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-200
22 korrik 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-045-2010, datë 09.08.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu.